

Proces-verbali i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak Kurbin

Data: 30.04.2025

Ora: 10:00

Salla: Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

Kryesuese: Znj. Edlira Lleshi

Të pranishëm: Eris Zymaj, Marjana Gjini, Lauren Sana, Sefedin Lika, Anton Kolziu, Edmond Stojani, Pashk Prenga, Ded Ndreca, Melisa Kalaja, Albert Ndoci,

Sekretar: Arbër Leka

Edlira Lleshi: Tek “Të ndryshmet” nuk keni kërkesa? Sepse ndodh që, pasi mbarohet mbledhja, thuhet: “Kam një kërkesë”, “Kam një tjetër”. Të lutem, Laurin, ndiz mikrofonin. Ok, provo tani.

Lauren Sana: Po, kam disa kërkesa për t’i futur te “Të ndryshmet” të rendit të ditës.

Edlira Lleshi: Laurin, e kam thënë disa herë që kërkesat bëhen në fillim të mbledhjes. Pastaj hidhen në votim për të parë nëse anëtarët e këshillit janë dakord që të përfshihen si pika shtesë te “Të ndryshmet”. Propozo tani çfarë ke dhe do ta hedh në votim.

Lauren Sana: Në rregull. Kam këto kërkesa: Vendorsja e koshave të plehrave në disa lagje; Një petition nga banorët e Lagjes nr. 2 për shtrimin e një rruge; Një sqarim në lidhje me disa punime që po zhvillohen gjatë muajit të fushatës.

Edlira Lleshi: Kush është dakord që këto kërkesa të futen në rend dite? Shtatë, tetë, nëntë... Kush është kundër? Miratohet. Kërkesat do të përfshihen në rend dite.

Edlira Lleshi: Ka kërkesa të tjera?

Sefedin Lika: Faleminderit, zonja kryetare. Dua të falënderoj për faktin që këtë herë kamerat janë fokusuar te të gjithë këshilltarët, jo vetëm te podiumi, siç ndodhi në mbledhjen e kaluar. Kam një ankesë nga banorët e fshatit Shullaz. U është mohuar një e drejtë që prej vitit 1992. Nuk është faj i këtij këshilli, por kërkoj ta diskutojmë.

Edlira Lleshi: Kush është dakord që kjo çështje të futet në rend dite? Kush është kundër? Miratohet. Ka kërkesa të tjera?

Anton Kolziu: Po. Qytetarët bëjnë kërkesa me shkrim për informacione drejtuar këshillit bashkiak, por nuk është parë ndonjë rast që këto të diskutohen këtu. Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të jetë i pranishëm drejtori i pyjeve dhe ai i rrugëve rurale, për të dhënë informacion për punën dhe shpenzimet në institucionet që drejtojnë.

Edlira Lleshi: Kërkesa pranohet, e futim në rend dite. Do të shpjegojmë edhe si funksionon interpelanca si procedurë.

Ded Ndreca: Kam një kërkesë në emër të familjes Rama në Mamurras. Kanë 50 vjet që jetojnë në një pallat me shenjë tërmeti, por janë lënë jashtë projekteve të bashkisë. Tani pallati është në

pronësi të bashkisë. Kërkoj nga bashkia dhe nga këshilli që kjo familje, e cila po jeton me çadër mes pallateve, të strehohet. Sipas ligjit, strehohet çdo familje, qoftë edhe ajo që nuk ka pasur banim të regjistruar më parë.

Edlira Lleshi: Kush është dakord që të futet në rend dite? Miratohet.

Albert Ndoci: Kam një kërkesë për informacion: Po bëhet një punim përballë Kalasë së Sebastes, është hapur një rrugë, dua të di detaje për këtë ndërhyrje.

Edlira Lleshi: E mbajtëm shënim. Kush është dakord që të futet në rend dite? Miratohet. I lutem sekretarit të këshillit dhe nënkryetarit të mbajnë shënim të gjitha kërkesat për informacion. Kalojmë te pika e parë: Miratimi i ndihmës ekonomike. Drejtor!

Z. Llesh Ndoci, Drejtor i Ndhmës Ekonomike Dhe Kujdesit Social: Në përgjigje të një kërkesë të paraqitur nga z. Stojani në mbledhjen e kaluar, sqaroi se në lidhje me një rast për ndihmën ekonomike, personi nuk ka aplikuar në sistem. Për të përfituar ndihmë ekonomike, kërkohet që të gjitha kartat financiare të jenë me vlerë zero. Në këtë rast konkret, z. përfiton pension invaliditeti, çka ndikon në përlllogaritjen.

Sistemi elektronik i ndihmës ekonomike është i lidhur me strukturat në Tiranë dhe kontrollohet rregullisht nga institucionet përkatëse, përfshirë Lezhën. Edhe në rastet kur një familje ka aplikuar për ndihmë dy apo tre vite më parë, nëse nuk përmbush kriteret apo nëse ka ndryshime në deklaram (automjete, prona, të ardhura apo mosparaqitje në Zyrën e Punës), sistemi i penalizon automatikisht.

Shumë aplikantë nuk shkojnë në Zyrën e Punës, çka është një kusht themelor. Mosparaqitja penalizon përfituesit me gjashtë muaj. Drejtori deklaroi se për të shmangur penalizimin, është marrë komunikim i drejtpërdrejtë me administratorët vendorë për të verifikuar rastet dhe për të thirrur aplikantët të kryejnë aplikimin. Në rast se nuk aplikojnë në sistem, ndihma ekonomike nuk mund të jepet.

Znj. Melisa Kalaja: Shpreh shqetësimin se disa familje nuk kanë dijeni apo mundësi për të aplikuar dhe për rrjedhojë rrezikojnë të humbin ndihmën ekonomike. Pyeti nëse Drejtoria e Shërbimit Social ka ndonjë mekanizëm për t'i identifikuar dhe për t'i ndihmuar në kohë.

Llesh Ndoci: Sqaroi se në katër njësitë administrative të bashkisë funksionojnë zyra të ndihmës ekonomike, të cilat kanë detyrim të njoftojnë familjet nëpërmjet telefonit ose duke shkuar në banesat e tyre. Si shembull përmendi një rast konkret ku qytetari nuk është paraqitur dhe sistemi e ka përjashtuar automatikisht.

Ai përmendi tri raste specifike: B.M., M.P. dhe ... M., të cilët do të përfshihen si përfitues të ndihmës ekonomike që prej muajit prill. U siguroi se projektvendimi nuk do të paraqitet në Këshillin e Bashkisë pa përfshirjen e këtyre tre emrave, pasi janë verifikuar nga strukturat përkatëse.

Ndërkohë, u përmendën edhe rastet e z. Gj., i cili ka kaluar në pension dhe nuk përfiton më ndihmë ekonomike, si dhe znj. E.M. nga Mamurrasi, e cila ka aplikuar por nuk është paraqitur kur është thirrur, duke humbur të drejtën.

Drejtori theksoi se në rastet kur ka dyshime apo nevojë për verifikim, anëtarët e këshillit mund të japin vetëm emrin e përfituesit, pa pasur nevojë të përfshihen më tej. Zyra e Shërbimit Social do të bëjë verifikimin dhe do të kthejë përgjigje brenda 24 orëve nëpërmjet administratorit të zonës.

Edlira Lleshi (Kryetare): Faleminderit drejtor. Pashk, a ke ndonjë pyetje?

Pashk Prenga: (Kryetar i Komisionit të Ekonomisë): Po. Ne si komision jemi dakord me miratimin e listës për ndihmën ekonomike të muajit të kaluar, por kemi një vërejtje: Qytetarëve u thuhet: “Nuk keni marrë pikët”, por nuk u shpjegohet cilat janë këto pikë dhe pse nuk i kanë marrë. Kërkoj që çdo qytetar të informohet në moment nga inspektori përkatës: “Nuk ke fituar pikë për këtë arsye, këtë arsye”.

Gjithashtu, dua të theksoj se çdo qytetar që ka vërejtje, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim në Këshillin e Bashkisë. Jam shumë dakord me Antonin: shumë qytetarë kanë bërë kërkesa, janë protokolluar në bashki, por nuk janë përcjellë në këshill. Ky fenomen nuk duhet të ndodhë më – kërkesat që drejtohen për këshillin, duhet të vijnë në këshill.

Edlira Lleshi: Kjo duhet verifikuar. Nëse keni emra konkretë të qytetarëve që kanë dorëzuar kërkesa, sillni këtu dhe do verifikojmë se ku ka mbetur shkresa.

Hedhim në votim ndihmën ekonomike. Kush është dakord? Kundër? Miratohet.

Kalojmë të pika “Të ndryshme”. Ju lutem të flasim sipas rradhës. Laurini i pari është. Vazhdo, pastaj është, Sefedini edhe Antoni.

Lauren Sana: Faleminderit, znj. kryetare. Kam katër kërkesa:

1. Në fshatin Shullaz, përballë varrezave, mbeturinat digjen – duhet urgjent një kosh.
2. Në lagjen Laskaj (Fushë Milot) kërkohet gjithashtu një kosh nga banorët.
3. Kam një pyetje për punimet që bëhen gjatë muajit të fushatës – është bërë zakon të fillojnë projektet në këtë kohë. Dua sqarim:
 - Kur janë tenderuar këto punime?
 - Sa është afati i kontratës?
 - Sa zgjat procesi?

Konkretisht flas për Zhejën – është mirë që po punohet, por kohët e fundit të fushatës krijojnë keqkuptime. Nuk është asgjë personale, por si përfaqësues kemi të drejtë të dimë se kur janë miratuar këto projekte. Po... po patjetër e thashë, shuëm mirë që po shtrohet edhe kaloni dhe nga Gjormi se mirë do bëni, por për afatin e tenderimit, mesa di unë kanë një afat katër mujor para zgjedhjeve.

Edlira Lleshi: Z. nënkryetar, nëse ke informacion, përgjigju tani që ta ezaurojmë këtë çështje. Nëse jo, Laurin, të lutem paraqiti me shkrim të gjitha pyetjet (kontrata, afati, etj.), dhe do të marrësh përgjigje zyrtare herën tjetër.

Lauren Sana: Në rregull. Shpresoj që këtë herë do të marrim përgjigje me shkrim, sepse deri tani nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje.

Sa i përket pikës tjetër: Në lagjen nr. 2 është dorëzuar një peticion nga banorët për Rregullimin e ujërave të zeza dhe Asfaltimin e rrugës në një gjatësi prej 100-120 metrash (tek zona e poligonit, aty ku ndahet me Ujësjiellësin). Ky peticion është protokolluar që në korrik (verë), por deri më sot nuk është bërë asnjë ndërhyrje dhe nuk është dhënë asnjë përgjigje. Do ta paraqes sërish me shkrim dhe do këmbëngul që të marrë përgjigje.

Edlira Lleshi: Në rregull. Për këtë peticion, **mbledhjen tjetër do të jepet përgjigje me shkrim.** Arbër, të ngarkohemi si detyrë ta verifikosh këtë peticion: **ku ka ngecur dhe çfarë është bërë me të.** Ti je sekretar dhe duhet t'i ndjekësh shkresat. Komunikoj me Laurenin dhe kërko protokollin përkatës. Tani të lutem, z. Sefedin.

Sefedin Lika: Faleminderit, znj. Kryetare. Faleminderit edhe ju kolegë. Ne jemi këtu për t'i shërbyer qytetarëve, pavarësisht bindjeve tona politike.

Unë kam ngritur një kërkesë për zonën e Shullazit. E kam për detyrë t'i përfaqësoj të gjithë banorët e Kurbinit, por banorët e Shullazit më drejtohen vazhdimisht me kërkesa, madje më thonë që jam "i tyrë", edhe pse historikisht familja ime ka ardhur nga Mali i Bardhë para 400 vitesh. Problemi që ngrihet është se në vitin 1992 është bërë një ndarje territoriale që, sipas banorëve, është e gabuar, ndoshta për interesa politike apo elektorale. Ata ndihen të ndarë padrejtësisht dhe kanë filluar të përgatisin dokumentacion për të ndjekur edhe rrugën gjyqësore. Ata më kërkojnë që t'ju ndihmoj që kjo çështje të rishqyrtohet dhe të korrigjohet nëse është e mundur. Nuk është kërkesë për përçarje, por për drejtësi administrative dhe kthim të së drejtës.

Edlira Lleshi: Sefedin, mund të na thuash konkretisht cila është kërkesa jote?

Sefedin Lika: Banorët e Shullazit kanë përgatitur kërkesa me dokumente dhe janë të gatshëm të ndjekin edhe rrugën gjyqësore. Ata duan bashkimin e Shullazit me territorin e vet historik, sepse ndarja që është bërë është e gabuar.

Edlira Lleshi: Me kë doni të bashkohet Shullazi?

Sefedin Lika: Shullazi dëshiron të bashkohet me zonën e Shullazit. Pra, kërkohet korrigjimi i një ndarjeje territoriale të bërë më parë, e cila sipas tyre është bërë për interesa të caktuara.

Edlira Lleshi: Kjo nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak. Vendimi për kufijtë administrativë është VKM (Vendim i Këshillit të Ministrave). Ne mund të shqyrtojmë vetëm çështje që janë në kompetencën tonë, dhe edhe ato i kemi të vështira për t'i zgjidhur.

Sefedin Lika: Të paktën, banorët kanë mbledhur firma dhe thonë që u është shkelur ligji. Ne nuk po themi që dikush të shkojë në prokurori, por të paktën **të mundohemi të bëjmë diçka** si përfaqësues të tyre.

Edlira Lleshi: Është shumë pozitive që po përpiqesh të kërkesh **rrugëzgjdhje për një problem real.** Të shohim nëse mund të ndërmjetësojmë apo ta përcjellim çështjen më lart. Anton?

Anton Kolziu: Problemin e letrave që i drejtohen këshillit e trajtoi Pashku më herët. Por dua të nënvizoj edhe një tjetër shqetësim: Kanë kaluar gati dy vite nga fillimi i këtij mandati, dhe deri më tani asnjë institucion i bashkisë nuk ka ardhur në Këshill për të dhënë llogari apo për të raportuar mbi performancën e punës së tyre. Për këtë arsye, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të jenë të pranishëm: Drejtori i Kullotave dhe Pyjeve dhe Drejtori i Rrugëve Rurale.

Edlira Lleshi: Arbër, të lutem mbaj shënim.

Anton Kolziu: Gjithashtu, tre mbledhje më parë, në prani të një nënkryetari tjetër të bashkisë, unë kërkoja informacion për rrugën e Poligonit, që ishte planifikuar për asfaltim. Ai më tha që në mbledhjen e radhës do të jepej informacioni, por kanë kaluar tre muaj dhe asgjë nuk është kthyer si përgjigje — as me shkrim, as verbalisht. Pra, edhe kur banorët paraqesin kërkesa me shkrim, edhe kur ne i bëjmë në mbledhje, përgjigjet nuk vijnë fare. Faleminderit.

Edlira Lleshi: Faleminderit ty. Nënkyetar, kur do të marrim përgjigje për këto kërkesa?

Nënkyetari i Bashkisë: Do të mblidhen informacionet për të gjitha kërkesat e anëtarëve të Këshillit. Mendoj që në mbledhjen e ardhshme do të jepen përgjigjet, dhe do të jenë të pranishëm edhe drejtori i rrugëve dhe drejtori i pyjeve, për të dhënë sqarime.

Edlira Lleshi: Faleminderit. Për sot s'kemi më çështje. Faleminderit të gjithëve.

Eris Zymaj: Po ne prisnim përgjigjen për çështjen e banesave dhe dyqaneve, që u ngrit nga kolegu dhe u mbështet nga të gjithë ne. Kishim pritshmëri që sot të kishim një përgjigje, por askush nuk është i pranishëm për të dhënë shpjegime. Pse ndodh kjo?

(nuk dëgjohet mire)

Edlira Lleshi: Mirupafshim.